



AKPT  
AGJENCIA KOMBËTARE E  
PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT



AIC  
Albanian  
Investment  
Corporation



# Konkurs Ndërkombëtar për Projekt-Ide

NË FOKUS TË RINJTË

# EXPO ALBANIA

Hapësira Fleksibël për Ekspozita | Panaire | Koncerte  
| Takime | Evenimente | Rekreacion | Logjistikë

# thirrje e hapur





# Tabela e përmbajtjes

<b>1. Përmbledhje rreth konkursit</b>	<b>04</b>		
1.1 Hyrje	04		
1.2 Promovuesit	04		
1.3 Manifest	04		
1.4 Përfituesit	06		
1.5 Autoriteti Organizues	06		
1.6 Procesi i konkursit	06		
Faza 1: Shprehja e interesit, pranueshmëria dhe të përzgjedhurit	06		
Faza 2: Dorëzimi i propozimeve për ide projektimi	06		
Kriteret e përzgjedhjes	07		
Shpërblimi i ekipeve të përzgjedhura për propozimin e idesë së projektimit	07		
1.7 Metodologjia e punës	08		
1.8 Pranueshmëria	09		
1.9 Profilet e ekspertëve			
1.10 Përbërja e Jurisë së Konkursit	10		
<b>2. Praktika e projektit</b>	<b>10</b>		
2.1 Konteksti i përgjithshëm - Tirana	10		
2.2 Konteksti i hapësirave për evenimente madhore në Tiranë	12		
2.3 Siti i konkursit	14		
2.4 Qëllimi dhe pyetjet e konkursit	15		
2.5 Objektivat e konkursit	16		
		2.6 Programi i projektimit	17
		<b>3. Shërbimet që kërkohen</b>	<b>17</b>
		3.1 Required Services	
		Faza 1: Shprehja e interesit dhe pranueshmëria (Të përzgjedhurit)	17
		Faza 2: Dorëzimi i propozimeve për ide projektimi	17
		3.2 Dokumentet e aplikimit	17
		Dokumentet dhe dorëzimet për Fazën 1	19
		Dokumentet dhe dorëzimet për Fazën 2	21
		3.3 Të drejtat e autorit	22
			22
		<b>4. Afatet dhe dorëzimet</b>	<b>22</b>
		4.1 Afatet dhe dorëzimet	22
		4.2 Udhëzime për dorëzimet	22
		Faza 1	22
		Faza 2	23
		4.3 Gjuha	23
		4.4 Kalendar i konkursit	
		4.5 Materiali bazë i konkursit	24
		<b>5. LISTA E SHTOJCAVE</b>	<b>24</b>
		SHTOJCA 1: Lista e materialeve shoqëruese	24
		SHTOJCA 2: Aspekte projektimi për hapësirat e ekspozimit dhe evenimenteve	25
			3

# 1 Përmbledhje rreth konkursit

## 1.1 Hyrje

Qëllimi i kësaj Thirrje është të shërbejë si udhërrëfyes për projektimin e një qendre ekspozimi shumëfunktionale që do të shërbejë për evenimente dhe aktivitete të ndryshme, duke lehtësuar grumbullimet publike për shkëmbimin e ideve, informacioneve, novacioneve, mallrave dhe shërbimeve, si dhe për rrjetëzim. Qendra duhet të projektohet për të shërbyer si një djep evenimentesh të larmishme, duke përfshirë panairë, ekspozita tregtare, koncerte dhe evenimente të tjera madhore. Projekti duhet të prioritetizojë fleksibilitetin, qëndrueshmërinë, aksesueshmërinë dhe funksionalitetin. Gjithashtu, projekti duhet të mundësojë fleksibilitet të mjaftueshëm për të lehtësuar shfrytëzimin alternativ dhe të shumëllojshëm të hapësirës gjatë periudhave kur eventet janë më të rralla.

## 1.2 Promovuesit

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (përmes njësisë Atelier Albania), me kërkesë të Kryetares së Grupit të Punës ngritur me Urdhër të Kryeministrit, si edhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 512, datë 30.08.2023 "Për ngarkimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të

Territorit ... për realizimin e konkursit të projektimit për projektidetë e zhvillimit të Tirana Expo...", shpall thirrjen e hapur për Konkursin Ndërkombëtar për Projekt-Ide Arkitektonike, në kërkim të zgjidhjes më të mirë të projektimit për zhvillimin e Expo Albania, një hapësirë fleksibël për ekspozita, panairë, koncerte, takime, evenimente, rekreacion dhe logjistikë, e cila do të jetë funksionale gjatë gjithë javës, për çdo muaj të vitit, dhe ku tematikat do të jenë kryesisht të fokusuara rreth të rinjve.

## 1.3 Manifest

Tirana ka përjetuar një rritje dhe transformim të jashtëzakonshëm gjatë 30 viteve të fundit. Me kalimin drejt një ekonomie të tregut të lirë, qyteti ka fituar, me hap të ngadaltë por të sigurt, një pozitë ekonomike solide dhe të diversifikuar falë karakteristikave të tij unike, si afërsia e tij me qendra të shumta rajonale dhe roli thelbësor që ai luan në disa zinxhirë të vlerës. Ajo çfarë vlen për t'u theksuar është se qyteti ka bërë hapa galopantë në sigurimin e zhvillimit të tij afatgjatë, duke investuar fuqishëm në krijimin dhe konsolidimin e partneriteteve kyçe në tregje të konsoliduara dhe në një sërë industrish të reja dhe në zhvillim e sipër, duke përfshirë teknologjinë e informacionit,

inteligjencën artificiale, prodhimin industrial etj. Këto industri dhe fushat e tyre përkatëse të veprimtarisë përfaqësohen nga një amalgamë organizatash dhe korporatash ndërkombëtare dhe shumëkombëshe, të cilat shpeshherë synojnë zgjerimin e aktivitetit të tyre në territore të reja dhe në zhvillim, duke sjellë në këto territore mundësi të konsiderueshme punësimi, ide të reja, rritje të kapaciteteve vendase përmes transferimit të njohurive dhe, rrjedhimisht, një përmirësim të ekonomisë vendase nëpërmjet investimeve të huaja direkte (IHD). Industria e MICE (takimeve, stimujve, konferencave, ekspozitave) është përgjegjëse për zhvillimin e aktiviteteve të biznesit dhe aktiviteteve argëtuese që përdorin këto organizata për të mbledhur grupe të mëdha interesi për promovimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të aktiviteteve të tyre. Me një vlerë prej më shumë se 650 milionë USD/vit, industria e MICE përfaqëson një sektor turizmi të rëndësishëm dhe në rritje, në të cilin qytetet globale po synojnë gjithnjë e më shumë të përfshihen. Shoqata Botërore e Industrisë së Ekspozitave (UFI) raportoi që në 2018 u zhvilluan rreth 32,000 ekspozita, të cilat tërhoqën 300 milion vizitorë dhe 5 milion ekspozitorë në 180 shtete. Impakti global ekonomik i sektorit ka gjeneruar rreth \$325 miliardë të ardhura dhe \$198 miliardë në kontribute ndaj PBB.

Për rrjedhojë, është tejet e rëndësishme që Tirana të jetë e mirëpozicionuar dhe e pajisur siç duhet në mënyrë që të mund të përfshihet dhe të korrë sukses në këtë treg fitimprurës, si për mundësitë që ai paraqet ashtu dhe për konsolidimin e statusit të qytetit si një destinacion i rëndësishëm për investimet e huaja.

Për më tepër, vizioni i Tiranës për një zhvillim të gjithanshëm dhe të integruar vendos gjithashtu një theks të fortë te skena e artit dhe muzikës në qytet. Muzikantë, piktorë, skulptorë dhe performues të rinj po zhvendosen gjithnjë e më shumë drejt Tiranës në kërkim të mundësive, sensit të përkatësisë dhe frymëzimit në një qytet artdashësish që ndajnë të njëjtat pasione me ta. Aktualisht, nxitja dhe konsolidimi i mëtejshëm i këtyre sektorëve bazohet te shfrytëzimi i disa hapësirave dhe objekteve të dedikuara (siç është Pallati i Kongreseve) apo i hapësirave të tjera fleksibël (qendra të ndryshme kulturore publike dhe sipërmarrje private), në përputhje me rrethanat. Megjithatë, këto objekte përballen me një sërë sfidash.

Shumë prej tyre janë tejet të amortizuara, kërkojnë mirëmbajtje të shpeshtë dhe nuk ofrojnë kapacitetet dhe komoditetet e

duhura që u nevojiten aktorëve prestigjozë shumëkombësh për të marketuar produktet dhe shërbimet e tyre. Objekte të tjera janë projektuar fillimisht për funksione të tjera dhe mund t'i kryejnë këto shërbime vetëm në një masë të kufizuar. Të tilla kufizime e limitojnë shumë shkallën dhe larmishmërinë e evenimenteve që mund të zhvillohen në këto objekte. Për më tepër, vendndodhja e objekteve ekzistuese në brendësi të qytetit krijon probleme me trafikun, aksesueshmërinë dhe parkimin, duke e bërë edhe më të vështirë zhvillimin e evenimenteve për grupe të mëdha njerëzish ose mbajtjen e organizimeve më komplekse.

Me zgjerimin e Tiranës dhe, rrjedhimisht, me rëndësinë gjithnjë e më të madhe që ka për rajonin progresi i Shqipërisë drejt integritit, vendi duhet të mirëpozicionohet për të shfrytëzuar mundësitë e ardhshme. Integrimi në BE dhe një ekonomi më solide dhe konkurruese prodhojnë cikle të frytshme që e bëjnë Shqipërinë dhe veçanërisht Tiranën një destinacion gjithnjë e më tërheqës dhe konkurrues për investorët e huaj. Megjithatë, këto investime kërkojnë një sërë infrastrukturash që duhet të implementohen për t'i kthyer këto perspektiva në realitet, ku vendin e parë e mban krijimi i hapësirave

dhe mjediseve të reja ku investorët dhe ndërmarrjet e huaja mund t'i reklamojnë siç duhet produktet dhe shërbimet që ofrojnë. Një qendër ekspozimi shumëfunktionale dhe bashkëkohore, do të siguronte një platforme tejet të nevojshme për aktivitete ekonomike të reja dhe për një gamë të gjerë evenimentesh të tjera kulturore, sociale dhe artistike. Paralelisht, kjo qendër unike me përdorim fleksibël mund të rrisë ndjeshëm vizibilitetin e Tiranës, si rrjedhojë edhe të Shqipërisë, si një destinacion për organizimin e panairëve, ekspozitave tregtare, takimeve në shkallë të gjerë dhe evenimenteve të tjera, duke e konsoliduar më tej reputacionin e kryeqytetit si një njeje të rëndësishme tregtare, sociale dhe kulturore në rajon dhe në nivel ndërkombëtar. Për më tepër, hapësirat dhe mundësitë që ofron kjo qendër e re mund të lehtësojnë pjesëmarrjen dhe integrimin e Tiranës në zinxhirët e vlerës, rrjetet dhe partneritetet tregtare ndërkombëtare.

Për rrjedhojë, është mjaft e rëndësishme që këtyre problematikave t'u jepet një zgjidhje përmes konceptimit të një hapësire të dedikuar për zhvillimin e duhur dhe të plotë të këtij programi të larmishëm. Hapësira e parashikuar do të pajiset plotësisht me të gjitha komoditetet e nevojshme për zhvillimin

e kësaj larmie funksionesh, duke ruajtur njëkohësisht fleksibilitet të mjaftueshëm për të shërbyer edhe për funksione të tjera kur nuk përdoret për programin e saj primar. Kjo hapësirë do të përfshijë disa salla ekspozimi, konferencash dhe mbledhjeje, auditorë si dhe të gjitha hapësirat e nevojshme mbështetëse, teknike dhe të magazinimit.

Ky konkurs ka për synim mbledhjen e propozimeve për realizimin e këtij vizioni përmes ideve novatore dhe largpamëse të projektimit që arrijnë të harmonizojnë një amalgamë kërkesash programatike, duke ruajtur ndërkohë një fleksibilitet të mjaftueshëm për të mundësuar edhe përdorime alternative.

#### 1.4 Përfituesit

Ky konkurs synon projektimin me qëllim ngritjen e një qendre ekspozimi shumëfunktionale të cilësisë së lartë, me kapacitetin për të akomoduar, marketuar dhe zhvilluar evenimente tregtare dhe kulturore në përputhje me kërkesat e larmishme dhe gjithnjë në rritje të një audience globale në një industri mjaft konkurruese. Ky projekt do ta shndërrojë Tiranën në një destinacion lider në rajon për organizimin e evenimenteve të industrisë, festivaleve të artit, panairove

tregtare dhe aktiviteteve të tjera të ngjashme, si rajonale ashtu edhe globale, me fokus kryesisht të rinjtë, duke i dhënë shtysë ekonomisë, njohurive dhe kapaciteteve novatore të qytetit dhe duke konsoliduar më tej rolin e tij në rajon si një destinacion dinamik. Përfituesit e drejtpërdrejtë të këtij projekti nuk janë vetëm të rinjtë, komunitetet e biznesit, artit dhe novacionit, por edhe vetë qyteti, i cili do të përfitojë nga ekspozimi i shtuar ndërkombëtar dhe nga rritja ekonomike (pasojë e pritshme).

#### 1.5 Autoriteti Organizues

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit është Autoriteti Organizues i procesit të konkursit, i cili do të zhvillohet në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 512, datë 30.08.2023 "Për ngarkimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit si organ qendror blerës për realizimin e konkursit të projektimit për projektidetë e zhvillimit të Tirana Expo, dhe për një shtesë fondi në buxhetin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, miratuar për vitin 2023" dhe në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në ligjin shqiptar për prokurimet publike.

#### 1.6 Procesi i konkursit

##### Faza 1: Shprehja e interesit, pranueshmëria dhe të përzgjedhurit

Ky është një konkurs i hapur ndërkombëtar për ide projektimi, i cili organizohet në dy faza. Në fazën 1 të aplikimit, kandidatët do të paraqesin përbërjen e ekipit, kualifikimet, metodologjinë e punës, si dhe deklaratën e vizionit të tyre për sitin, duke përfshirë një përmbledhje të konceptit paraprak. Kandidatët duhet të dorëzojnë kërkesat për shprehjen e interesit dhe dokumentacionin që kërkohet nga kjo Thirrje dhe DST-të.

Autoriteti Kontraktues do të shqyrtojë dokumentacionin e dorëzuar nga kandidatët dhe do t'i raportojë jurisë së konkursit. Kandidatët të cilët nuk përmbushin kriteret e kualifikimit të përmendura në Dokumentet e Tenderit do të skualifikohen dhe do të njoftohen menjëherë.

Juria do të vlerësojnë kandidatët e kualifikuar bazuar në përbërjen e ekipit të tyre, përvojën e mëparshme, metodologjinë, deklaratën e vizionit dhe idenë paraprake. Në fund të kësaj faze, Juria do të përzgjedhë 5 (pesë) ekipet dhe konceptet më të mira që do të përzgjidhen për të vijuar punën për fazën 2.

## Faza 2: Dorëzimi i propozimeve për ide projektimi

Në fazën 2, Juria do të shqyrtojë me kujdes propozimet e ekipeve të përzgjedhura dhe, bazuar në kriteret e fazës 2, do të përzgjedhë propozimin fitues. Në fillim të kësaj faze, Autoriteti Kontraktues do t'i dërgojë një ftesë secilit ekip të përzgjedhur për të dorëzuar propozimet për ide projektimi për sitin përkatës. Pas marrjes së propozimeve finale për idetë e projektimit, Autoriteti Kontraktues do t'i marrë ato në shqyrtim për t'u siguruar se ato përmbushin kriteret e parashtruara në këtë Thirrje dhe DST-të. Propozimet e kualifikuara do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga Juria e Konkursit bazuar në kriteret e parashtruara në këtë Thirrje.

Juria do të shpallë ekipin fitues bazuar në përzgjedhjen e kujdesshme të projekt-propozimit më të mirë. Autoriteti përkatës do t'i japë ekipit fitues kontratën për realizimin e projektit pas negociatave dypalëshe për tarifën, afatet kohore dhe dorëzimet.

### Kriteret e përzgjedhjes

Juria do të zgjedhë ekipin/ofertën fituese (Faza 2) bazuar në kriteret e mëposhtme:

- **Përvoja:** Ekipi i projektimit duhet të ketë përvojë të mëparshme në projektimin e objekteve për hapësira ekspozimi/ evenimentesh, dhe duhet të ketë një portofol me punë të mëparshme të ngjashme.
- **Kreativiteti:** Ekipi i projektimit duhet të dëshmojë një qasje kreative dhe novatore ndaj projektimit të qendrës së ekspozimit.
- **Ekspertiza teknike:** Arkitekti dhe ekipi fitues duhet të kenë ekspertizë teknike në projektimin e hapësirave komplekse dhe duhet të jetë në gjendje të zhvillojë plane dhe specifikime të detajuara.
- **Kostoja:** Tarifa e propozuar duhet të jetë në nivel të përafërt me çmimet e tregut lokal dhe në një vlerë konkurruese me ofertat e tjera.

### Shpërblimi i ekipeve të përzgjedhura për propozimin e idesë së projektimit

Secili ekip i përzgjedhur do të shpërblehet në shumën prej **40 000 euro** për dorëzimin e koncept idesë.

Ekipi fitues do të fitojë kontratën për realizimin e projektit (pas negociatave dypalëshe) dhe do të zbrësë shumën e shpërblimit për dorëzimin e koncept idesë (**40 000 euro**) nga tarifa për realizimin e projektit të zbatimit.

## 1.7 Metodologjia e punës

### Ekipet e profesionistëve vendas dhe të huaj

Ne nxisim dhe mbështesim pjesëmarrjen e profesionistëve vendas dhe të huaj që punojnë bashkërisht me njëri-tjetrin. Ne besojmë se ky bashkëpunim në ekip do ta përmirësojë mënyrën se si projektet dhe studimet mbështeten me të gjitha njohuritë e duhura vendase dhe me një nivel ndërkombëtar të ekspertizës projektuese. Për më tepër, ka shumë rëndësi që konkurset të shihen si procese bashkëkrijuese ku projektuesit dhe anëtarët e komunitetit vendas përfshihen në një ushtrim zhvillimor ndërveprues. Secili ekip ndërkombëtar nxitet nga organizatorët që të hyjë në partneritet me një ekip vendas dhe secili ekip vendas nxitet që të hyjë në partneritet me një palë të huaj homologe. Autoriteti Organizues beson se ky bashkëpunim mund të rrisë ndikimin e propozimit dhe të përmirësojë fizibilitetin e zbatimit. Ky nuk është një kriter përzgjedhjeje paraprake, e megjithatë një partneritet i tillë në këtë fazë është shumë i dobishëm dhe mund të ndihmojë me krijimin e një vizioni më koherent dhe të kontekstualizuar, i cili mund të rrisë shanset e ekipeve për t'u përzgjedhur.

## 1.8 Pranueshmëria

Konkursi është i hapur për ekipet e ekspertëve me përvojë në projekte arkitekturore dhe të zhvillimit urban që përmbushin kërkesat e përcaktuara në këtë dokument dhe në DST-të. Ekipi projektues duhet të përbëhet nga profesionistë me përvojë të mëparshme në fushën përkatëse. Ekipet duhet të përmbushin kërkesat sipas shtojcës 9 të DST-ve:

- të jenë të regjistruar ose të njohur nga një organ akreditues në vendin e ushtrimit të profesionit të aplikantit; ose
- në rastin kur nuk zbatohet ligji i njohjes apo i regjistrimit, aplikanti duhet të jetë anëtar i një institucioni profesionist në vendin e ushtrimit të profesionit.

Çdo ekip që merr pjesë në Fazën 1 duhet të përfshijë të paktën: një kryearkitekt, arkitekt projektues, arkitekt peizazhi, projektues urban, artist, planifikues eventesh, inxhinier strukturash dhe preventivues të kostove ndërtimore.

Të gjithë aplikantët/ofertuesit dhe anëtarët e tyre të ekipit duhet të identifikohen qartë dhe të deklarojnë vlefshmërinë e regjistrimit profesional, të njohjes profesionale ose të anëtarësisë profesionale në Deklaratën e Përbërjes së Ekipit.

## 1.9 Profilet e ekspertëve

### Kryearkitekt

- Të paktën 10 vite përvojë profesionale.
- Licencat përkatëse të kërkuara: kategoria 2.b-1 (për arkitektët vendas) ose licenca të barasvlershme nga vendi i ushtrimit të profesionit (për arkitektët e huaj).
- Të paktën një përvojë përkatëse projektimi/zbatimi në një projekt të një shkalle ose kompleksiteti të ngjashëm (specifikuar në CV)

### Arkitekt projektues

- Të paktën 5 vite përvojë profesionale.
- Të paktën një përvojë përkatëse projektimi në një projekt të një shkalle **ose** kompleksiteti të ngjashëm (specifikuar në CV).

### Arkitekt peizazhi

- Të paktën 5 vite përvojë profesionale.
- Licencat përkatëse të kërkuara: kategoria 2.d. (për arkitektët vendas të peizazhit) ose licenca të barasvlershme nga vendi i ushtrimit të profesionit (për arkitektët e huaj).
- Të paktën një përvojë përkatëse projektimi në një projekt të një shkalle **ose** kompleksiteti të ngjashëm (specifikuar në CV)

### Projektues urban

- Të paktën 5 vite përvojë profesionale.
- Licencat përkatëse të kërkuara: kategoria 1.c. (për arkitektët vendas) ose licenca të barasvlershme nga vendi i ushtrimit të profesionit (për arkitektët e huaj).
- Të paktën një përvojë përkatëse projektimi në një projekt të një shkalle ose kompleksiteti të ngjashëm (specifikuar në CV)

### Artist

- Përvojë me instalacione arti në hapësira publike (specifikuar në portofol).

### Planifikuesi i eventeve

- Të paktën 5 vite përvojë profesionale.
- Të paktën një përvojë përkatëse në projekte të një shkalle ose kompleksiteti të ngjashëm (specifikuar në CV)

### Inxhinier i strukturave

- Të paktën 10 vite përvojë profesionale.
- Licencat përkatëse të kërkuara: kategoria 3.b.2. ose 3.c.1. (për inxhinierët vendas të strukturave) ose licenca të barasvlershme nga vendi i ushtrimit të



- profesionit (për inxhinierët e huaj).
- Të paktën një përvojë përkatëse projektimi në një projekt të një shkalle **ose** kompleksiteti të ngjashëm (specifikuar në CV)

mbështeten përgjatë të gjithë kohëzgjatjes së këtij konkursi nga Sekretariati Teknik, i cili ka në përbërje anëtarë të Autoritetit Organizues, të cilët janë ekspertë në fushat përkatëse.

### Preventivues i kostove ndërtimore

- Të paktën 5 vite përvojë profesionale.
- Të paktën një përvojë përkatëse projektimi në një projekt të një shkalle **ose** kompleksiteti të ngjashëm (specifikuar në CV).

### 1.10 Përbërja e Jurisë së Konkursit

Juria e Konkursit do të ketë 7 (shtatë) anëtarë, ku të gjithë do të jenë profesionistë me përvojë në fushat përkatëse. Përbërja e Jurisë së Konkursit duhet të jetë e tillë që të përfshijë ekspertë vendas (3 anëtarë) dhe ndërkombëtarë (3 anëtarë) të projektimit, si dhe një përfaqësues të komunitetit të sipërmarrësve. Anëtarët e Jurisë së Konkursit do të njoftohen jo më vonë se një javë përpara datës së vlerësimit - siç është deklaruar në kalendarin e konkursit. Kjo do të shpallet në faqen e internetit të konkursit. Në faqen e konkursit do të jepet një biografi e shkurtër e secilit prej anëtarëve të jurisë.

Anëtarët e jurisë do të asistohen dhe

## 2 Thirrja e Konkursit

### 2.1. Konteksti i përgjithshëm - Tirana

Tirana është kryeqyteti i Shqipërisë dhe qyteti më i madh në vend, me një popullsi prej rreth 800 000 banorësh. Si epiqendra ekonomike e Shqipërisë, Tirana është djepi i industrive dhe veprimtarive ekonomike të shumta. Qyteti ka një fokus të veçantë të shërbimit, duke përfshirë financën, arsimin dhe kujdesin shëndetësor, si dhe turizmin.

Një ndër sektorët ekonomikë më madhorë në Tiranë është ndërtimi, me investime të konsiderueshme në infrastrukturë dhe në projekte ndërtimi gjatë viteve të fundit. Qyteti strehon gjithashtu një sërë industrish prodhimi, si industria elektronike, industria tekstile dhe industria e përpunimit të ushqimit. Tirana ka gjithashtu një sektor teknologjik në rritje, me një numër të madh biznesesh të reja dhe shoqërisht të konsoliduara që operojnë në qytet. Qeveria ka marrë hapa për të mbështetur rritjen e këtij sektori, duke përfshirë edhe krijimin e një parku teknologjik.

Tirana ka përjetuar një zhvillim ekonomik të fuqishëm gjatë viteve të fundit, me një rritje të theksuar të PBB-së për frymë. Qyteti ka bërë hapa të konsiderueshme në përmirësimin e klimës së tij të biznesit gjatë viteve të fundit, me prezantimin e reformave dhe masave nga

qeveria për tërheqjen e investimeve të huaja dhe për mbështetjen e nismave sipërmarrëse.

Në raportin e Bankës Botërore të vitit 2022 për lehtësinë e të bërit biznes, Shqipëria u rendit e 69-ta nga 190 vende, duke shfaqur përmirësim krahasuar me vitin e kaluar. Raporti theksoi se Shqipëria ka bërë një progres të konsiderueshëm për sa u përket treguesve që lidhen me krijimin e bizneseve të reja, marrjen e kredive dhe mbrojtjen e investitorëve të pakicës. Qeveria shqiptare ka prezantuar gjithashtu një sërë nismash për investitorët e huaj, si përjashtime nga taksat dhe reduktim të procedurave burokratike. Për më tepër, vendi ka një normë relativisht të ulët të tatimit mbi fitimin, në shkallën 15%, e cila mund të reduktohet më tej deri në 5% për sektorë dhe rajone të caktuara.

Tirana karakterizohet gjithashtu nga një forcë punëtore me nivel të lartë arsimimi dhe nga një përqindje e konsiderueshme e popullsisë njohëse të gjuhës angleze dhe gjuhëve të tjera evropiane. Qyteti është gjithashtu lehtësisht i aksesueshëm dhe me opsione të shumta transporti drejt pjesëve të tjera të Shqipërisë dhe të rajonit.

Ndonëse Tirana mund të jetë ende duke u përballur me problematika të shumta si një qytet që po zgjerohet me shpejtësi, mund të thuhet se ajo ka një klimë të favorshme biznesi për shoqëritë ndërkombëtare, veçanërisht në sektorët e financës, teknologjisë dhe turizmit. Për rrjedhojë, është e nevojshme që ky rekord përmirësimi dhe rritjeje të shfrytëzohet për të ruajtur dhe konsoliduar ritmin pozitiv të zhvillimit të qytetit.

### 2.2 Konteksti i hapësirave për evenimente madhore në Tiranë

Disa ndërtesa akomodojnë dhe organizojnë evenimente të tilla si panairë dhe ekspozita në Tiranë. Edhe pse këto ndërtesa kanë mundësuar organizimin e disa evenimenteve të ndryshme, me rritjen e vazhdueshme të profilit dhe nivelit të Tiranës, kufizimet në kapacitetet e tyre bëhen gjithmonë e më të dukshme. Pallati i Koncerteve, Tirana Expo Center, dhe Expo City Albania janë tre hapësira për zhvillimin e evenimenteve brenda dhe afër kryeqytetit. Më poshtë paraqiten përshkrime të shkurtra të secilës:

### Pallati i Koncerteve (Ish-pallati i Kongreseve)

Pallati i Koncerteve është një monument referimi për kulturën dhe evenimentet në Shqipëri. I ndërtuar në vitin 1986, në fillim synohej të përdorej si një qendër shumëfunktionale. I projektuar nga arkitektë shqiptarë, forma trekëndore moderniste e ndërtesës simbolizon terrenin e thyer të Shqipërisë. Salla e gjërë qendrore ka një kapacitet prej 2200 personash dhe është e dekoruar me llambadarë, murale dhe një tavan prej mozaiku që pasqyrojnë historinë dhe kulturën shqiptare.

Pas vitit 1990, përdorimi i pallatit ndryshoi ndjeshëm. Sot, përdoret si një qendër kulturore e rëndësishme që organizon evente të ndryshme, përfshirë këtu koncerte, performanca, ekspozita, dhe mbledhje të grupeve të mëdha. Në pallat janë bërë rinovime për të modernizuar hapësirat dhe për t'u siguruar që të mbetet një qendër kryesore për eventet në Shqipëri, si për shkak të kapacitetit, ashtu edhe vendndodhjes së tij (përgjatë Bulevardit qendror të Tiranës).

### Tirana Expo Center


Tirana Expo Center, një investim privat, i cili duket se nuk është aktiv momentalisht, mund të përshkruhet si një qendër që shërbente për paraqitjen e ekspozitave dhe zhvillimin e eventeve në Tiranë, Shqipëri. Ajo ofron mjedise dhe infrastrukturë për zhvillimin e panairëve tregtare, ekspozitave, konferencave dhe eventeve të tjera. Qendra ofron salla dhe dhoma mbledhjeje të shumta që mund të përshtatshin me nevojat e eventeve të ndryshme. Salla më e madhe që ofrohej kishte një sipërfaqe totale prej 4000 m<sup>2</sup> dhe kapacitet prej 4000 personash. Tirana Expo Center gjendet në veriperëndim të Tiranës, afër vendbanimit të Kamzës, në një zonë me trafik të konsiderueshëm, që rezultoi në rënien e kërkesës për përdorimin e qendrës.

### Expo City Albania

Expo City Albania është një tjetër investim privat, i cili gjendet në autostradën Tiranë-Durrës, afër vendbanimit të Vorës. Qendra e eventeve është planifikuar të ketë kapacitet për 5000 persona me një sipërfaqe totale prej 30 000 metrash katror. Qendra operative e përditësuar ndodhet në një distancë të konsiderueshme nga qendra e qytetit dhe ka një frekuentim periodik, krahasuar me qendrat e tjera që ndodhen më afër kryeqytetit.

### 2.3 Siti i konkursit


Tirana është një qytet me një rritje të shpejtë që së fundmi ka përfutur zhvillime të mëdha në infrastrukturë si pasojë e nevojës së tij për t'u zgjeruar. Projektet e një niveli të madh si ky - një qendër ekspozimi që pasqyron vizionin për ta kthyer Tiranën në një qendër rajonale të njohur të rrjetëzimit, argëtimit, njohurive dhe inovacionit - kanë nevojë për një hapësirë të madhe dhe të lidhur shumë mirë. Siti i propozuar gjendet përgjatë unazës së jashtme të Tiranës, me një lidhje të shpejtë me aeroportin, Korridorin Blu (korridori Adriatiko-Jonian që lidh Malin e Zi, Shqipërinë dhe Greqinë), Korridorin VIII (rruga Egnatia), dhe Portin e Durrësit. Siti i propozuar, një ish-zonë ushtarake e përdorur si zonë parkimi për helikopterë, ka një madhësi prej rreth 6 hektarësh, nuk ka ndërtesa dhe ka një pjerrësi të lehtë për nga jugperëndimi.



### Karakteristikat:

Koordinatat: 41°18'41.41"N 19°52'47.58"E  
 Sipërfaqja e lotit: 61 817 m<sup>2</sup>  
 Aksesit: Hyrja kryesore: Rruga e unazës lindore (rrugë kryesore interurbane)

Distanca:  
 Nga qendra e qytetit të Tiranës: 7,67 km  
 Nga Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës: 27,51 km



## 2.4 Qëllimi dhe pyetjet e konkursit

Ky konkurs ka për qëllim të gjenerojë ide dhe propozime të reja për rikonceptualizimin e përgjithshëm të sitit të përzgjedhur, për krijimin e një qendre evenimentesh fleksibël, me kapacitet të lartë dhe që mund të përdoret për qëllime të ndryshme. Propozimet duhet t'i përgjigjen kontekstit duke marrë në konsideratë dhe duke integruar një sërë tipologjish, duke përfshirë panairë, ekspozita tregtare, koncerte dhe ekspozita, por jo vetëm, me një sistem mjedisesh fleksibël, që mund të akomodojnë një shumëllojshmëri konfigurimesh hapësinore. Objekti dhe hapësirat përbërëse të tij duhet t'i lejojnë organizuesve të evenimenteve mundësi të mjaftueshme për të mos kufizuar kreativitetin, madhësinë dhe ambicien në projektimin e standave dhe ekspozitave të tyre. Duke pasur këtë liri, organizuesit e evenimenteve (shpesh përfaqësues të organizatave të nivelit global) mund të prezantojnë punën, produktet dhe ofertat e tyre në mënyrën më të mirë të mundshme, duke siguruar që ata të kenë një bashkëpunim dhe përvojë pozitive dhe produktive me vendin ku zhvillohet evenimenti dhe, si rrjedhojë, me qytetin e Tiranës si destinacion.

Konkursi do të bazohet në tre detyrat vijuese:

1. Propozimin për sitin e konkursit për qendrën e re fleksibël dhe shumëfunktionale të ekspozimit dhe lidhjen e saj me rrjetin e qytetit dhe kontekstin më të gjerë;
2. Hartimin e një programi të përgjithshëm hapësirash për përdorime të shumta, për një gamë të gjerë përdoruesish me prejardhje, nevoja dhe moshë të ndryshme;
3. Propozimin e idesë së projektit arkitekturor për zhvillimin e Expo Albania, një hapësirë fleksibël për ekspozita, panairë, koncerte, takime, evenimente, rekreacion dhe logjistikë që funksionon gjatë gjithë javës, çdo muaj të vitit, duke mbajtur në konsideratë që kjo qendër do të ketë në fokus kryesisht të rinjtë.

Projekt-propozimet duhet t'i përmbahen kërkesave të përcaktuara në Thirrje dhe në dokumentacionin shoqërues dhe duhet të synojnë të:

- Promovojnë Tiranën si qendër rajonale për rrjetëzim;
- Ofrojnë një programim dhe projektim funksional që pasqyron dhe promovon karakteristikat e projektit dhe ambiciet e tij;
- Krijojnë mundësi dhe kapacitete për funksione me përdorim të shumëfishtë,

veçanërisht për aktivitete kulturore, tregtare dhe arsimore, si dhe për shërbime, duke mbajtur në fokus kryesisht të rinjtë.

Një propozim i suksesshëm i përgjigjet mirë pyetjeve të mëposhtme:

- Si mund të planifikojmë një qendër ekspozitash dhe evenimentesh që tërheq vendimmarrësit kryesor në industrinë tregtare dhe krijuese dhe nxit aktivitetin në zonë?
- Si mund të krijojmë hapësira të ndryshme, duke ofruar një pritje tërheqëse për një mori sektorësh, organizatash dhe temash të mundshme?
- Si mund të projektohet një qendër e tillë aktivitetesh të ndryshme, ku përveç se do t'i shërbehet të gjitha moshave, në fokus do të jenë të rinjtë?
- Si mund t'i projektojmë hapësirat për të lejuar përdorimin e tyre në funksione të tjera kur nuk përdoren në rolin e tyre kryesor për evenimente?
- Si mund t'i lehtësojmë kërkesat e vizitorëve duke integruar sjelljet dhe preferencat e tyre me trendet dhe teknologjitë në zhvillim?
- Si mund të sigurojmë lidhje të suksesshme dhe efikase të funksioneve të ndryshme dhe fluks të pandërprerë

midis hapësirave të ndryshme në program?

- Si mund të projektojmë hapësira që i lejojnë vizitorëve të bëhen pjesë e përvojës brenda dhe përreth ambienteve të qendrës?
- Si mund të garantojmë lëvizshmëri të mirë në zonë, akses efikas dhe të sigurt nëpër hapësira, nga përdoruesit dhe nga komuniteti përreth?
- Si mund të përmirësojmë cilësinë dhe estetikën e kontekstit përreth përmes projektimit të kësaj qendre?
- Si mund të integrojmë teknologjinë dhe të krijojmë hapësira rezistente ndaj kohës, për të mundur kurimin e suksesshëm e panairove, ekspozitave tregtare dhe evenimenteve, sot dhe në të ardhmen?
- Si mund të lehtësojmë organizimin dhe pjesëmarrjen në evente në formate virtuale dhe fizike?

## 2.5 Objektivat e konkursit

Rezultati i këtij konkursi do të jenë zgjidhjet e projektimit për një hapësirë evenimentesh me kapacitet të lartë, me një bashkësi të integruar dhe fleksibël hapësirash dhe facilitetesh, të cilat mund të tërheqin dhe akomodojnë lehtësisht evenimente nga

sektorë të ndryshëm në të gjithë rajonin. Kjo hapësirë e re do të shërbejë si një nyje kyçe në rolin dinamik të qytetit si një destinacion rajonal tregtar, kulturor, artistik dhe akademik. Në këto evenimente përfshihen ekspozitat tregtare, panairët, ekspozitat, pavionet artistike dhe arkitekturore, koncertet dhe jo vetëm.

Çdo konkurrenti do t'i kërkohet të trajtojë dhe sintetizojë çështjet e mëposhtme gjatë procesit të projektimit:

- Të studiojë zonën objekt të konkursit dhe rrethinat e saj. Të ofrojë një analizë të thelluar të zonës objekt të propozimit, të ndërtuar pas shqyrtimit të dokumentacionit, takimeve me ekspertët dhe vizitave në sit, për të pasqyruar kushtet aktuale dhe për të justifikuar propozimin;
- Të ofrojë një projekt-propozim arkitekturor që synon të krijojë një pamje të jashtme të dallueshme duke siguruar njëkohësisht fleksibilitetin e hapësirës së brendshme për të akomoduar një gamë të gjërë evenimentesh;
- Të eksplorojë sinergjitë funksionale në projektimin e programit të ndërtesës dhe të planimetrisë - të parashikojë përdorime fillestare dhe dytësore të hapësirës që lejojnë fleksibilitet dhe ofrojnë njëkohësisht facilitete dhe

infrastruktura të përshtatshme për një sërë konfigurimesh hapësinore;

- Të integrojë modularitetin në projektimin e planimetrisë për të përmirësuar lehtësinë dhe intuitivitetin me të cilin mund të projektohen standat ose ekspozitat individuale;
- Të theksojë ofrimin e një game të larmishme komoditetesh që plotësojnë nevojat e vizitorëve dhe pjesëmarrësve që marrin pjesë në të gjitha tipologjitë e evenimenteve;
- Të maksimizojë prodhimin e energjisë së gjelbër dhe të rinovueshme duke shfrytëzuar në maksimum sipërfaqen e gjerë të zonës - të synojë krijimin e një ndërtese që nuk emeton karbon ose që redukton karbonin që është tashmë në hapësirë.
- Të ofrojë aksesueshmëri për të gjithë, me rampa, ashensorë dhe hapësira të tjera që garantojnë rehatinë dhe sigurinë e përdoruesve;
- Çdo zgjidhje duhet të sigurojë kreativitet të lartë, përdorim të teknologjisë më të fundit, efikasitet në kosto, përputhje me legjisllacionin shqiptar në fuqi dhe zbatimin e praktikave më të mira për projektimin e tipologjive të tilla;

- Të përgatisë dhe të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar, siç specifikohet në këtë Thirrje dhe në Dokumentet Standarde të Tenderit (DST-të); Në rast të ndonjë konflikti ose mospërputhjeje ndërmjet kërkesave të parashtruara, rendi i përparësisë do të jetë: (1) DST-të, (2) Termat e Referencës (Thirrja);
- T'i paraqesë propozimin jurisë (vetëm ekipet e përzgjedhura), në datën që do të njoftohet nga organizatorët;
- Në rast përzgjedhjeje si fitues (vetëm ekipi i përzgjedhur), të ketë vullnetin dhe kapacitetin për të vazhduar me fazat e tjera të zhvillimit.

Kërkesat e detajuara të projektit që do t'i udhëzojë konkurrentët gjatë fazës 2 të konkursit do të ndahet vetëm me konkurrentët e përzgjedhur nga faza 1. Për të diskutuar Kërkesat e projektit dhe kriteret e tij, do të mbahet një seminar online me pjesëmarrjen e aktorëve të përfshirë. Data e seminarit do të shpallet më vonë.

## 2.6 Programi i projektimit

Propozimi duhet ti përmbahet kërkesave të përcaktuara nga termat e mëposhtëm dhe duhet të jetë në përputhje me legjislacionin

në fuqi për standardet dhe rregullat e ndërtimit. Propozimet e suksesshme duhet të përmbushin kriteret minimale vijuese, të cilat nuk janë shteruese, por shërbejnë si kufizime të nevojshme për një projektim efikas.

### Programi i hapësirës

Expo Albania synon të jetë hapësira më e madhe e ekspozimit në Shqipëri dhe në rajon. Ajo duhet të ketë:

- **një sallë kryesore ekspozimi** 10 000 m , në një kat,
  - plotësisht modulare dhe që mund të ndahet në disa salla më të vogla;
  - të paktën 8 salla;
  - me lartësi 12 m.
- **hapësira ekspozimi plotësuese në kate të ndërmjetme,**
  - rreth 2000 m ;
  - me lartësi 4 m.
- **zona shpërndarjeje dhe shërbimi** dhe hapësira lidhëse,
  - holle të dedikuara dhe korridore qarkullimi;
  - recepsione të dedikuara dhe/ose të përbashkëta (grupuara) për bileta;
  - zona shërbimi të dedikuara dhe/ose të përbashkëta (grupuara);
- **një hapësirë të jashtme ekspozimi** me sipërfaqe 5000 m ;
  - të lidhur drejtpërdrejt me sallën kryesore të ekspozimit
- **një hapësirë fleksibël për takime, konferenca** dhe evenimente me sipërfaqe 5000 m , në 1 deri 2 kate
  - plotësisht modulare dhe që mund të ndahet në disa salla/dhoma më të vogla;
  - të paktën 10 salla;
  - me lartësi 6-8 m.
- hapësira për **magazinim** dhe **logjistikë**, me sipërfaqe të paktën 5000 m ,
  - për qëllime operacionale;
  - për t'u dhënë me qira;
- hapësira **parkimi**,
- preferohen që të jenë kryesisht nëntokë,
  - rreth 500 makina.
- zona **katering**,
  - Restorante dhe kioska.
- hapësira **argëtimi** për fëmijë;
- zona dhe **sipërfaqe të gjelbra**,
- **shërbime akomodimi**
  - maksimumi 5000 m ,
  - shumëkatëshe,
  - hotel me 3-4 yje.



Expo Albania duhet të projektohet duke u bazuar në teknologjinë më të fundit në lidhje me projektimin, ndërtimin, sigurinë dhe operimin.

Expo Albania duhet të projektohet për të qenë e gatshme të akomodojë ekspozita, panairë dhe evenimente që mbulojnë një gamë të gjerë sektorësh, si: ai i ndërtesave, ndërtimit, inxhinierisë, prodhimit, pasurive të paluajtshme, menaxhimit, shëndetit, mjekësisë dhe farmaceutikës, shtëpive, kopshteve, dhuratave, kozmetikës, bukurisë, të dhënave, IT dhe teknologjisë, energjisë, automobilistikës, transportit, medias dhe kontentit, kulturës 'pop', lojërave elektronike, shtypshkrimit dhe paketimit, sigurisë dhe

mbrojtjes, sportit dhe mirëqenies, udhëtimit dhe turizmit.

Konfigurimet e ndryshme për sallat e ekspozimit dhe evenimenteve duhet të marrin në konsideratë planimetri të ndryshme si "teatër", "festa", "pritje", "darka", bazuar në përdorime të ndryshme si prezantime, pritje, konferenca, seminare, kongrese, festa të stafit ose prezantim produkti".

Aspektet minimale të projektimit për ekspozitat dhe hapësirat e evenimenteve janë paraqitur në shtojcën 3 të kësaj Praktike (në fund të dokumentit).

# 3 Shërbimet që kërkohen

## 3.1 Shërbimet që kërkohen

### Faza 1: Shprehja e interesit dhe pranueshmëria (Përzgjedhja)

1. Të dorëzohet koncept-ideja paraprake;
2. Të dorëzohen dokumentet mbështetëse të aplikimit;
3. Dokumentet të dorëzohen në adresën e Organizatorëve të Konkursit (kopje elektronike dhe fizike) brenda afatit të përcaktuar.

### Faza 2: Dorëzimi i propozimeve të koncept-idesë

- Të hartohet propozimi për koncept-idenë;
- Të përgatiten materialet shoqëruese, duke përfshirë:
  - Maketin,
  - Raportin e projektit,
  - Preventivin paraprak të propozimit (kostot e zbatimit), dhe
  - Vlerën e përllogaritur për ekzekutimin e projektit.
- Dokumentet të dorëzohen në adresën e Organizatorëve të Konkursit (kopje elektronike dhe fizike) brenda afatit të përcaktuar;
- Të prezantohet propozimi i koncept-idesë përpara Jurisë (në datën që do të përcaktohet)

## 3.2 Dokumentet e aplikimit

Aplikantët në konkurs duhet të dorëzojnë disa dokumente, për të plotësuar kërkesat e konkursit për Fazën 1 dhe Fazën 2. Këto dokumente janë të karakterit ligjor, informues dhe projektues.

Çdo detaj në lidhje me dokumentacionin që duhet dorëzuar për t'u kualifikuar në konkurs do të jepet në shtojcën 9 të DST-ve. Lista e mëposhtme është vetëm për qëllime informimi; ju lutemi t'i referoheni dokumentit të lartpërmendur për kërkesat dhe formularët e plotë zyrtarë që duhen dorëzuar.

### Dokumentet dhe dorëzimet për Fazën 1

Dorëzimet duhet të lidhen si dy dokumente PDF, të organizuar në kapituj të renditur dhe të titulluar sipas strukturës më poshtë, ku Vizatimi dhe Ilustrimet e Konceptit (Paraprak) do të përbëjnë një Dosje dhe pjesa tjetër e Dokumenteve do të përbëjnë Dosjen tjetër.

Lidhjet e mirëorganizuara do ta ndihmojnë Autoritetin Organizues dhe anëtarët e jurisë që të vlerësojnë përputhshmërinë e çdo dorëzimi me kërkesat e DST-së.

### *Ju lutemi, ndiqni këto udhëzime!*

1. Shprehje interesi
2. Jetëshkrimet (CV-të) e stafit kryesor kryesor (ku evidentohen përvojat e mëparshme të lidhura me projektin) dhe portfoli (i kryearkitektit/studios drejtuese dhe projektuesve);
3. Metodologjia e punës
4. Deklarata e vizionit
5. Vizatimet dhe ilustrimet e konceptit paraprak
  - a. Çdo aplikant/ofertues do të paraqesë material grafik të mjaftueshëm në mënyrë që anëtarët e jurisë të mund të kuptojnë dhe vlerësojnë konceptin në mënyrë të paanshme. Qartësia e paraqitjes së materialeve do të mbështesë përcjelljen e idesë tek anëtarët e jurisë.
6. Të gjitha dokumentet e tjera ligjore dhe financiare, ose vetë-deklarimet e lidhura me aplikimin, sipas specifikimeve të DST-ve, shtojca 9, që përfshijnë:
  - a. Kriteret e përgjithshme të pranueshmërisë/ kualifikimit
    - i. Aplikanti/ ofertuesi duhet të deklarojë se ai/ajo/ata:
      1. është/janë i/e/të regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku

- ushtron/ushtrojnë aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka/kanë në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit dhe ka/kanë statusin aktiv;
2. nuk është/janë në proces falimentimi (status aktiv);
  3. nuk është/janë dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të ligjit për prokurimet publike (LPP);
  4. personi/personat që vepron/veprojnë si anëtar/ë të organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksionari ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim gjyqësor i formës së prerë për ndonjë vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
  5. nuk është/janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
  6. nuk ka/kanë pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet/ndodhen në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
  7. ka/kanë paguar faturat e energjisë elektrike dhe plotëson/plotësojnë kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për aplikantët/ofertuesit, të cilët veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
  8. nuk është/janë në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
  9. ushtron/ushtrojnë veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
  10. ka/kanë paraqitur një aplikim të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
  11. kryen/kryejnë aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
  12. nuk ka në cilësinë e Ofertuesit, persona të cilët janë/kanë qenë të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- b). Kriteret e mësipërme përmbushen me dorëzimin e përmbledhjes së "Formularit të vetë-deklarimit" të aplikantit/ ofertuesit, në ditën e dorëzimit, sipas shtojcës 10 të DST-ve.
- c). Në rastin e një Bashkimi Shoqërisht të Ofertuesve, secili anëtar ofertues i grupit duhet të dorëzojë vetë-deklarimin e sipërpërmendur.
- d). Në rastet kur aplikanti/ofertuesi do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, "Formulari i vetë-deklarimit" i sipërpërmendur duhet dorëzuar edhe nga entitetet mbështetëse.
- e). Kriteret e përgjithshme të kualifikimit nuk duhen ndryshuar nga Autoriteti Organizues.
- f). Në çdo rast, Autoriteti Organizues ka të drejtën të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit më sipër të deklaruar nga aplikanti/ ofertuesi.

g). Nëse aplikimi paraqitet nga një Bashkim Shoqërisht të aplikantëve/ ofertuesve, aplikantët/ofertuesit duhet të ofrojnë:

i. Një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet tyre, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkimin e shoqërive, dhe detyrat/përgjegjësitë që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit të shoqërive.

h). Nëse një aplikant/ofertues dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai/ajo i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## II. Kriteret e veçanta të kualifikimit

a). Aplikanti/ofertuesi duhet të paraqesë:

i. Përmbledhjen e "Formularit të vetë-deklarimit" sipas shtojcës 10 të DST-ve;

ii. Kapacitetin ekonomik dhe financiar:

1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet e fundit financiare **2020, 2021, 2022**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **1,000,000 Lek**. Për operatorët e huaj, në rastet kur dokumentet e kërkuara nuk janë lëshuar në shtetin e origjinës, për të vërtetuar deklaratat e bilancit/pasqyrave financiare ose xhiron vjetore, mund të dorëzojnë një deklaratë për konfirmimin e tyre.

## Dokumentet dhe dorëzimet për Fazën 2

a). Propozimi i detajuar i koncept-idesë

b). Propozimi i detajuar i preventivit paraprak për zbatimin e projektit (kostot e zbatimit)

c). Propozimi i argumentuar i tarifës së projekt-zbatimit

Propozimi i kërkuar për dorëzimin e fazës 2 duhet të përfshijë të paktën listën vijuese të dokumenteve:

i. Materiale që vizualizojnë propozimin (Panele polisterol/ "foam" A0 - maksimumi 10 panele)

1. Planimetri, prerje dhe lartësitë e propozimit;

2. Diagrama funksionale;

3. Diagrama koncepti dhe vizatime (lëvizshmëria/qarkullimi, parkimi, strukturore);

4. Koncepte dhe planimetri të projektimit urban;

5. Koncepte dhe specifika të projektimit të peizazhit;

6. Diagrama të specifikave kryesore teknike;

7. Rendera dhe vizualizime.

ii. Raportin e propozimit (në format A4 ose A3), që përfshin:

1. Qasjen dhe metodologjinë e projektimit;
2. Frymëzimet, precedentët, referencat;
3. Analizën e kontekstit;
4. Identifikimin e nevojave të aktorëve;
5. Përshkrimin dhe prezantimin e propozimit;
6. Planin e punës;
7. Specifikat e hapësirave dhe kapaciteteve (diagrama, përshkrime të shkruara);
8. Elementet dhe specifikimet funksionale (diagrama, përshkrime të shkruara).
9. Preventivin paraprak të propozimit (kostot e zbatimit).

iii. Maketin e sitit në shkallë (shkalla të përcaktohet nga ekipi)

iv. Prezantimin e propozimeve në Powerpoint/ Keynote (duke përfshirë video-animime - sipas dëshirës).

### 3.3 Të drejtat e autorit

Të gjitha dorëzimet dhe vizatimet e konkurrentëve bëhen pronë e përbashkët e Autoritetit Organizues, i cili fiton të drejtën e publikimit, riprodhimit dhe përdorimit për qëllime të ndryshme institucionale. Pronësia intelektuale e çdo projekti të dorëzuar është e autorit.

# 4 Afatet dhe dorëzimet

## 4.1 Afatet dhe dorëzimet

Aplikantët dhe ekipet e tyre përkatëse dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me afatet, siç përcaktohet në këtë dokument dhe DST-të. Në rastin e një ndryshimi në programin e punës, Autoriteti Organizues është i detyruar të njoftojë palët e tjera brenda një afati kohor të arsyeshëm.

Fazat e konkursit dhe kontrata pasuese janë si në vijim:

Faza 1: Kualifikimi paraprak dhe përzgjedhja/shortlistim

Faza 2: Faza e projektimit të konceptit - konkurrimi i kandidatëve të përzgjedhur

Faza 3: Kontraktimi i kandidatit fitues për punën e projektimit të detajuar

## 4.2 Udhëzime për dorëzimet

Ekipet do të përgatisin dhe do të dorëzojnë zyrtarisht dokumentet e kërkuara pranë zyrave të Autoritetit Organizues – Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) – dhe nëpërmjet adresës së emailit të konkursit.

## Faza 1

Dokumentet duhet të dorëzohen në 1 (një) kopje të printuar dhe të firmosur në adresën postare të Autoritetit Organizues, bashkë me një CD të materialit digjital. 1 (një) kopje elektronike e materialit duhet dërguar në adresën e emailit të konkursit.

### **Adresa e emailit e konkursit:**

[ExpoAlbaniaCompetition@gmail.com](mailto:ExpoAlbaniaCompetition@gmail.com)

## Faza 2

Panelet duhen të dorëzohen në format A0, panele polisteroli/"foam", në 1 (një) kopje të printuar, ndërkohë që raporti duhet të dorëzohet në format letre A4 ose A3, në 10 (dhjetë) kopje të printuara. Disa kopje të raporteve do t'i shpërndahen Anëtarëve të Jurisë dhe pjesa e mbetur do të ruhet në arkivën e Autoritetit Organizues.

Kopjet e printuara, bashkë me 1 (një) CD të materialeve dixhitale dhe një maket në shkallë duhen dorëzuar në adresën e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.

1 (një) kopje elektronike e paneleve (format origjinal/ i editueshëm dhe PDF), raporti (format i editueshëm dhe PDF) dhe prezantimi (format i editueshëm dhe PDF) duhet të dërgohen në adresën e emailit të konkursit.

## Adresa postare:

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit,  
Rruga "Muhamet Gjollësja", Nr. 57,  
Tiranë, Shqipëri

## 4.3 Gjuha

Të gjitha dokumentet e kërkuara duhet të dorëzohen plotësisht në shqip, ose në anglisht.

#### 4.4 Kalendari i konkursit

Thirrje e hapur për shprehje interesi 29 dhjetor 2023

Periudha e parë e pyetjeve 29 dhjetor 2023 – 1 shkurt 2024

**Afati Faza 1** **12 shkurt 2024**

Përzgjedhja 15 shkurt 2024

Ftesa për të dorëzuar koncept-ide projektimi 23 shkurt 2024

Periudha e dytë e pyetjeve 23 shkurt 2024 – 1 prill 2024

**Afati Faza 2** **15 prill 2024**

Prezantimet publike dhe vlerësimi i jurisë 18 prill 2024

Organizimi i ekspozitës/ publikimit 18 prill 2024

#### 4.5 Materiali bazë i konkursit

##### **Figurat dhe skicat (vizatimet)**

I gjithë dokumentacioni i nevojshëm grafik që i duhet aplikantëve për të punuar do të vihet në dispozicion për shkarkim në faqen e konkursit dhe në një dosje të përbashkët Google Drive.

##### **Lista e dokumenteve të ngarkuara në dosjen GDrive:**

- Një kopje e Termave të Referencës
- Dokumentet për sitin e konkursit:
  - Plani i sitit (në format Autocad të editueshëm dwg); imazhe satelitore; ortofoto; foto (foto të sitit dhe të objekteve specifike); informacion GIS; specifikime të planit të përgjithshëm vendor; plane të ndërtesave ekzistuese

Faqja e internetit e konkursit:

Shqip  
[LIDHJA](#)

Anglisht  
[LIDHJA](#)

Lidhja për në dosjen Google Drive  
[LIDHJA](#)

## SHTOJCA 1: Lista e materialeve shoqëruese (gdrive)

- Planvendosjet
- Fotografitë e sitit
- Ortofotografi
- Imazhe satelitore
- Informacionet GIS dhe të përdorimit të tokës (siç përcaktohen në planin e përgjithshëm vendor)

## SHTOJCA 2: Aspekte projektimi për hapësirat e ekspozimit dhe evenimenteve

Përmbajtja e kësaj shtojce nuk është detyruese, por mund të shërbejë si referencë për studiot pjesëmarrëse

### Aspektet minimale të projektimit

- Krijoni plane, diagrama dhe skica të qarta për hyrjet e caktuara të shërbimeve, ashensorët, dhe doket e ngarkesave për transportin e stafit dhe materialeve;
- Sigurohuni që projekti të përfshijë një zgjidhje efikase hapësire për shkarkimin dhe ngarkimin e mjeteve të transportit përmes ofrimit të dokeve të ngarkesës që lejojnë transferimin në kohë, të sigurt dhe pa probleme të materialeve
- Ofroni lehtësira të mjaftueshme për

vizitorët, në mënyrë që prania dhe aktiviteti i tyre të mos shqetësojë dhe të mos shqetësohet nga aktivitetet kryesore logjistike dhe teknike gjatë përdorimit të hapësirave. Kjo mund të kërkojë sigurimin e hapësirave të ndara për organizuesit dhe nënkontraktorët, të ndara nga vizitorët dhe publikun e përgjithshëm.

- Sigurohuni që në të gjitha hapësirat e brendshme të mos lejohet duhani dhe që në zonat ku lejohet, të shënohet me sinjalistikë të mjaftueshme për të ftuarit, vizitorët, stafin dhe kontraktorët.
- Ofroni hapësira të ndryshme të përshtatshme për një gamë të gjerë funksionesh të synuara dhe të parapriara dhe nivele të përdorimit të hapësirës. Këto mund të përfshijnë:
  - Hapësirat në projektim duhet të jenë mjaftueshëm fleksibël që të mbajnë panairë, ekspozita, ekspozita tregtare, koncerte, evenimente, konferenca, etj.,
  - Sallat duhet të jenë të lidhura me njëra tjetrën për të lejuar rezervimin e disa hapësirave për një eveniment të vetëm, megjithatë mjaftueshëm fleksibël për të lejuar ndarjen e brendshme në një sallë të vetme, nëse kërkohet

### Qarkullimi në hapësirat e ekspozimit dhe evenimenteve

- Të gjitha korridoret e brendshme duhet të jenë të paktën 3 metër të gjera.
- Daljet e emergjencës nuk duhet të bllokohen. Duhet të lejohet një boshllëk prej të paktën tre (3) metrash.
- Çdo dalje emergjence e fshehur nga shikimi do të kompensohet me sinjalistikë shtesë.
- Krijoni një skicë të rrugës së sugjeruar të qarkullimit për përdorimin e hapësirave nga aktorë të ndryshëm:
  - Klientët
  - Publiku
  - Përfaqësuesit
  - Kontraktorët dhe nënkontraktorët
- që shërbimet të mos presin rrugën e korridoreve, bllokojnë daljet, ndërhyjnë me funksionimin e daljeve të emergjencës, ose të ndikojnë në përgjithësi në shëndetin dhe sigurinë e pjesëmarrësve, të stafit dhe publikut të përgjithshëm.



### Ndriçimi i emergjencës

- Ndriçimi i ofruar nga ndriçimi normal dhe ndriçimi i emergjencës duhet të jetë i mjaftueshëm për të lejuar këdo të shohë rrugën për të dalë nga stendat, sallat e seminareve dhe teatrove në çdo kohë.
- Ndriçimi horizontal në nivel dysHEMEJE që ofrohet nga cilido burim përgjatë vijës qendrore të rrugëve të caktuara të daljes nuk duhet të jetë më pak se 0.2 lux dhe preferohet 1 lux. (ExCel London)

### Menaxhimi i mbetjeve

- Siguroni infrastruktura të përshtatshme të menaxhimit të mbetjeve në vend për një shumëllojshmëri rrjedhash të mbetjeve të parashikuara (duke përfshirë por pa u kufizuar te mbetjet plastike, organike dhe tregtare),
- duke përfshirë zonat e caktuara dhe rrugët e qarkullimit për mbledhjen, transferimin, dhe/ose asgjësimin e sigurt, efikas dhe jo shqetësues të mbetjeve

### Organizimi dhe sinjalistika

- Ofroni udhëzime të mjaftueshme për përdorimin e hapësirave që stafet dhe klientët mund të përdorin hapësirat e ofruara nga projektimi në mënyrë efikase dhe të sigurt
- Skiconi procedurat e evakuimit, sigurisë dhe shëndetit në planet e qarkullimit për secilën nga hapësirat e veçanta të përfshira në projektimin total
- (së bashku me vizatimet teknike dhe specifikimet e nevojshme për realizimin e projektimit), ofroni dokumente skematike për organizuesit dhe planifikuesit e evenimenteve, duke ofruar të gjithë informacionin e nevojshëm në detaje për organizim pa ndërprerje dhe të sigurt (montimi, funksionimi dhe çmontimi) të stendave, ekspozitave dhe shfaqjeve të evenimenteve
- Pajisjet e personalizuara të përfshira në projektim duhet të jenë mjaftueshëm të specifikuar dhe dokumentuara, duke përcaktuar nivelet minimale të certifikimit për përdorimin e tyre efikas, të sigurt dhe të pandërprerë.

### Sistemi i evakuimit nga zjarri dhe i sigurisë

- Projekti i propozuar duhet të ketë një sistem automatik evakuimi të sigurt nga zjarri, të lidhur me një sistem zëri PA.
- Zorrat propozuar duhet të ketë një sistem automatik evakuimi të sigurt nga zjarri, të lidhur me një sistem zëri PA.
- Në çdo dhomë me tavan të ngurtë duhet të vendosen detektorë tymi të pavarur, me distancë prej 10 metrash ose më shumë nga njëri tjetri.
- Duhet të ofrohet një plan sigurie i cili identifikon rreziqet e mundshme dhe mënyrën se si do të menaxhohen rreziqet.

### Manuali/standardet e ekspozimit

Përveç specifikimeve të projektimit, propozimi fitues (pasi të jetë fituar kontrata) duhet gjithashtu të përgatisë draftin për një manual ekspozimi, duke ofruar në detaje informacion teknik dhe njohuri për të komunikuar dhe siguruar procedurat dhe protokollet për përdorimin e duhur të hapësirave nga stafi dhe nga organizuesit e evenimenteve, siç është konceptuar në vizionin e ekipit fitues

të projektimit. Ky manual mund të përfshijë, por nuk kufizohet domosdosmërisht në informacionin në vijim:

- inventari i hapësirave të caktuara, kapaciteteve dhe programeve të sugjeruara për çdo hapësirë
- Kërkesat teknike duke përfshirë programet e përgatitjes
- Detajet/kërkesat e sigurisë
- Detajet/kërkesat e pastrimit
- Çdo specifikim të arredimit ose pajisjeve që kërkojnë mirëmbajtje ose përdorim të veçantë
- Planet e sinjalistikës
- Skemat e qarkullimit për organizuesit e evenimenteve
- Specifikimet e komunikimit, energjisë, ujit dhe ajrit të kondicionuar
- Shërbimet aktuale të ekspozuesit
- Rregullat për modifikimin e planimetrive nëse ka kufizime të projektimit

Kini parasysh se ekipet e projektimit mund të përmendin gjithashtu standarde të ndryshme ISO përkatëse për të siguruar përputhshmërinë me standardet më të larta të shërbimit. Këto mund të përfshijnë:

- ISO 20121 Sistemet e menaxhimit të aktiviteteve të qëndrueshme
- ISO 50001 Sistemet e menaxhimit të energjisë
- ISO 22000 Sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore
- ISO 22301 Sistemet e menaxhimit për vazhdimësinë e aktivitetit